

Dokumenti përmbledhës i projektit (DPP)

Emri I Projektit:	Transporti Urban i Prishtinës
Shteti:	Kosovë
Numri identifikues i Projektit:	46489
Spektori:	Infrastruktura Komunale dhe e Mjedisit
Publik/Privat:	Publik
Data e targetuar e Bordit:	06 Maj 2015
Statusi:	Ka kaluar shqyrtimin e konceptit, mbetet shqyrtimi final.
Data e botimit të DPP-së në gjuhën Angleze:	20 Shkurt 2015
Data e përditësimit të DPP-së:	
Përshkrimi i projektit dhe objektivat:	<p>BERZH është duke shqyrtuar mundësinë e ofrimit të një kredie Trafikut Urban (“Kompania” apo “TU”), kompania e transportit urban në Prishtinë, për modernizimin e flotës së autobusëve të saj përmes blerjes së 51 autobusëve të rinj dizel kompatibil me standardin EUR VI dhe me dysHEME të ulët.</p> <p>Projekti përfshinë renovimin e depos ekzistuese për mirëmbajtjen e autobusëve. Kosto totale e projektit është 13.2 milion euro, prej të cilave me 3.2 milion euro do të kontribuoj komuna e Prishtinës për financimin e renovimit të depos së mirëmbajtjes dhe TVSh-së.</p> <p>Projekti pritet të përmirësoj gjendjen aktuale të flotës së autobusëve të kompanisë duke rezultuar në përmirësimin e ndjeshëm të performancës së sajë operative dhe mjedisore, si dhe të përmirësimin të standardeve të sigurisë.</p> <p>Projekti do të zbatohet nga Njesia e Zbatimit të Projektit e mbështetur nga konsulentët e jashtëm të financuar nga fondet për bashkëpunim teknik.</p> <p>Suksesi i projektit do të matet nga standardet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">• Numri i përgjithshëm i pasagjerëve të transportit urban transportuar në ditë;• Reduktimi në ton i CO2-së ekuivalent për operacionet

e përmirësuara të transportit publik.

Ndikimi në tranzicion:	Potenciali i ndikimit në tranzicion i projektit rrjedh nga: <ul style="list-style-type: none">• Krijimi i Kontratës së Shërbimit Publik në mes të komunës dhe kompanisë;• Zhvillimi i një Plani të Qëndrueshëm të Mobilitetit Urban për Prishtinën, i fokusuar në praktikatat më të mira të planifikimit të transportit urban dhe pjesëmarrje më të madhe të sektorit privat;• Potencial për rritjen e pjesëmarrjes së sektorit privat në operimin dhe mirëmbajtjen e terminalit qendror të autobusëve;• Përmirësim i qendrueshmërisë financiare në kuadër të kompanisë nëpërmjet rikuperimit të kostos dhe efikasitetit të operimit të paraqitura nga një program për përmirësimin e performancës financiare dhe operacionale ("PPPFO").
------------------------	--

Vlerësimi i prituri i ndikimit në tranzicion:	Potenciali i ndikimit në tranzicion: Mirë Reziku i ndikimit në tranzicion: I lartë
---	---

Klienti:	Trafiku Urban, në pronësi të plotë nga komuna e Prishtinës dhe përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të transportit publik në zonat urbane dhe periferike të qytetit dhe komunave fqinje. Kompania është themeluar në vitin 1976 dhe aktualisht punëson 118 punonjës. Ajo operon 10 autobusë për Linjën 4, e cila kalon nëpër qendër të qytetit.
----------	--

Financimi nga BERZH:	10 milion euro kredi për kompaninë, të garantuara nga Republika e Kosovës.
----------------------	--

Kosto totale e projektit:	Deri në 13.2 milion euro (përfshirë TVSh-në).
---------------------------	---

Kategorizimi mjedisor dhe social, ndikimi dhe masat lehtësuese.	Kategoria B. Ndikimet mjedisore dhe sociale që lidhen me shpërndarjen e 51 autobusëve të rinj me naftë me dysheme të ulët, dhe rihvillimin e depos ekzistuese, pritet të jenë specifike sa i përket lokacionit dhe mund të identifikohen lehtësisht dhe menaxhohen nëpërmjet zbatimit të masave të përshtatshme zbutëse. Vlerësimi i ndikimit mjedisor është ndërmarrë nga një konsulent i pavarur. Kjo përfshiu rishikimin e sistemeve të menaxhimit dhe aktiviteteve të kompanisë; një auditim i depos së mirëmbajtjes dhe një analizë mjedisore e programit të propozuar të investimeve. Vlerësimi jep indikacion se nuk ka çështje të mëdha, por që kompania ka nevojë për të përmirësuar menaxhimin e përgjithshëm Mjedisor dhe Social ("M&S") dhe të burimeve njerëzore. Një Plani i Veprimit për çështjet Mjedisore dhe Sociale ("PVMS") është rënë dakord që përfshin kërkesën për të zhvilluar një sistem të menaxhimit të Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit ("MSS"), standardet dhe procedurat për biznesin dhe emërojnë stafin përgjegjës për zbatim; përmirësoj performancën mjedisore dhe shëndetësore dhe të sigurisë
---	--

në vendin e depos; të zbatojë një sistem të menaxhimit të sigurisë të trafikut dhe trajnim për shoferët; të përgatisë një plan të reagimit emergjent; dhe të zbatojë procedurën e ankesës për punëtorët. Një Plan Angazhimi i Grupeve të Interesit ("PAGI") gjithashtu është dakorduar.

Planet e hollësishme për rihvillimin e depos ende nuk janë zhvilluar, edhe pse shpronësim i tokës nuk është parashikuar në këtë kohë. Planet përfundimtare do të jenë subjekt i një vlerësimi të veçantë pasi të jenë finalizuar dhe çdo masë zbutëse e kërkuar do të përfshihen në një PVMS të përditësuar.

Bashkëpunimi teknik:

Projektet e mëposhtme të Bashkëpunimit Teknik janë paraparë si pjesë e këtij projekti:

Para nënshkrimit të kontratës:

- Analizë për ndikimin mjedisor dhe social (40,000 euro, të financuar nga burimet vetanake të Bankës).
- Analizë Teknike për të përcaktuar specifikimet teknike të njësive të autobusëve (50.000 euro, të financuar nga burimet vetanake të Bankës).

Pas nënshkrimit të kontratës:

- Ndihma për Njësine e Zbatimit të Projektit për tenderimin dhe mbikëqyrjen e punimeve (kostoja e vlerësuar e detyrës është deri në 74.000 euro, që do të financohet nga një donator ndërkombëtar).
- Përgatitja e Programit për Përmirësimin e Performancës Operative dhe Financiare ("PPPFO") (kostoja e vlerësuar e detyrës është deri në 250.000 euro, që do të financohet nga një donator ndërkombëtar).
- Përgatitja e një Kontrate të Shërbimit Publik (50.000 euro, financuar nga Fondit i Veçantë Aksionarëve të BERZH ("SSF") sipas një marrëveshje ekzistuese kornizë).
- Përgatitja e Planit të Qëndrueshëm të Mobilitetit Urban ("PQMU") (vlerësimi i shpenzimeve totale të këtij projekti është deri në 275.000 euro, që do të financohet nga një donator ndërkombëtar).

Për mundësitë e konsulentëve për projektet e financuara nga fondet e bashkëpunimit teknik, vizitoni [procurement of consultants](#).

Mundësitë për prokurim dhe tenderim:

Vizitoni [EBRD Procurement](#)
Pyetjet: Tel: +44 20 7338 6794; Fax: +44 20 7338 7472
Email: procurement@ebrd.com

Pyetjet e përgjithshme:

Për pyetje të përgjithshme për projekte te BERZH që nuk ndërlidhen me prokurimin:

Tel: +44 20 7338 7168; Fax: +44 20 7338 7380

Email: projectenquiries@ebrd.com

Politika për Informimin e Publikut (PIP)

PIP përcakton se si BERZH jep informacione dhe këshillohet me grupet e saj të interesit në mënyre që të promovojë rritjen e ndërgjegjësimit dhe mirëkuptimin e strategjive, politikave dhe aktiviteteve të saj:

Teksti i PIP mund të gjendet në:

<http://www.ebrd.com/about/policies/pip/index.htm>

Mekanizmi i Ankesave të Projektit (MAP)

BERZH ka krijuar Mekanizmin e Ankesave të Projektit (MAP) për të siguruar një mundësi për një shqyrtim të pavarur të ankesave nga një ose me shumë individë ose nga organizata në lidhje me projekte të financuar nga Banka të cilat pretendohet të kenë shkaktuar ose mund të shkaktojnë efekte negative. Rregullat e procedurës së MAP mund të gjenden në:

<http://www.ebrd.com/about/integrity/irm/about/pcm.pdf>

Çdo ankese e MAP duhet të paraqitet jo më shumë se 2 muaj pas shpërndarjes së fundit të fondeve të BERZH-it. Ju mund të kontaktoni zyrtarin e MAP në adresën (at pcm@ebrd.com) ose Zyrën përkatëse të Përfaqësisë së BERZH për ndihmë nëse nuk jeni të sigurt për kohën se kur duhet të paraqitet një ankese.
